



DP 19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT

Nr. 5680 Prot.

Tiranë, më 27 / 3 /2023

UDHËZIM

Nr. 7, datë 27.3 2023

**PËR
NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 35, DATË 21.09.2020
“PËR KONTROLLIN, RREGJISTRIMIN, PËRDORIMIN, RAKORDIMIN,
RAPORTIMIN DHE PUBLIKIMIN E FONDEVE TË FINANCIMEVE TË HUAJA NË
KUADRIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimit nr. 35 (prot 17416), datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, në kushtet kur institucionet e pavaruara nënshkruajnë marrëveshje dhurimi/granti me institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, ministri përgjegjës për financat e qeverisë,

UDHËZON

1. Pas paragrafit 4.2 të udhëzimit nr. 35 (prot 17416), datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

4.2 –

Përfundimisht nga ky rregull bëjnë institucionet e pavaruara të cilat nënshkruajnë marrëveshje dhurimi/granti nga institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, vetëm kur këto marrëveshje nuk parashikojnë angazhime shtesë për buxhetin e shtetit apo nuk janë të parashikuara në buxhetin e institucionit përkatës.

Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale të projekteve të huaja në Bankën e Shqipërisë nga nëpunësi autorizues i institucionit të pavarur/njesisë së zbatimit të projektit të financimit të

huaj grant urdhërohet nga ministri përgjegjës për financat dhe i adresohet strukturës përgjegjëse për Thesarin sipas formatit në aneksin nr. 4.2 bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen institucionet e pavaruara dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ



ANEKS 4.2

Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë

I. Kërkesa e NJZP për DPThesarit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2023

Lënda: Kërkesë për çelje llogarie speciale

Referencë:

Z/ZNJ. _____

MINISTËRI I FINANCEVE DHE EKONOMISË
ADRESA: BLV "DËSHMORËT E KOMBIT", NR. 3, TIRANË

I/E nderuar _____,

Mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj", ju paraqesim kërkesën për çeljen e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin "... Leader x%" me specifikimet e mëposhtme:

- a) Emërtimi i llogarisë që kërkohet të hapet (i njëjtë me emërtimin e projektit);
- b) Lloji i financimit (grant ose kredi);
- c) Emërtimi i donatorit ose kreditorit;
- ç) Monedha e disbursimit;
- d) Shuma e financimit të huaj;
- dh) Shuma e transhit të parë;
- e) Koha e përafërt kur mbërrin transhi i parë;
- f) Kontakt email/telefon

Kërkesa bazohet në marrëveshjen teknike të dhurimit/grantit të nënshkruar me institucionet ndërkombëtare dhe qeveritë e shteteve të huaja, e cilat gjenden bashkëlidhur kësaj kërkesë.

Lutemi njoftimin e numrit të llogarisë në momentin e çeljes pranë institucionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

TITULLARI
Emër Mbiemër
Firmë